



D

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT

Nr.17140/1 Prot.

Tiranë, më 28 07.2017

Lënda: Kthim përgjigje

Z. VENIGJAR BEGAJ

Rruga "Komuna e Parisit". Pallati 4, Ap.9 L

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 19.07.2017, të protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr. 17140 Prot., datë 19.07.2017, regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 28, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", në lidhje me ankimin tuaj për vendimin e marrë nga DRT Tiranë, lidhur me refuzimin për dhënie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtarë, ju sqarojmë si më poshtë:

Administrata tatimore ushtron detyrat e saj funksionale bazuar në dispozitat e ligjit të saj material. Në referim të sa më sipër, administrata tatimore në përmbushje të detyrave të saj funksionale është një institucion ekzekutues dhe zbatues, dhe që udhëhiqet nga parimi për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit, parashikuar nga neni 12/a) i Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" i ndryshuar. Në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore, administrata tatimore ka detyrimin ligjor ti ofrojë shërbim dhe asistencë përfaqësuesit ligjor të shoqërisë apo përfaqësuesit të emëruar me prokurë për të përfaqësuar shoqërinë në raport me administratën tatimore, sipas parashikimeve konkrete të nenit 35, të ligjit të sipërcituar.

Lidhur me rastin konkret, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, ka mbajtur një qëndrim zyrtar lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, në harmoni me parashikimet e neneve 24, 25 dhe 31, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, qëndrim të cilin e vlerësojmë të drejtë dhe ligjor.

Referuar Ekstraktit Historik të shoqërisë gjeneruar nga faqja zyrtare e QKB, z.Venigjar Begaj, ish-administrator të shoqërisë "Certified Solution Corporation", me NIPT K82101016Q, i

ka mbaruar afati i emërimit në datë 27.08.2013 dhe aktualisht nuk ka tagër dhe nuk legjitimohet si përfaqësues i kësaj shoqërie.

Nga të dhënat e administruara, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur hapjen e procedurës së falimentit për shoqërinë "Certified Solution Corporation", me NIPT K82101016Q dhe ka caktuar si administrator falimenti Znj.Anida Nuri, e cila aktualisht legjitimohet të veprojë për dhe në emër të shoqërisë në marrëdhënie me debitorët, kreditorët, gjykatën etj.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, dokumentacioni i kërkuar, (akt kontrolli dhe dokumentat provuese në lidhje me detyrimet tatimore), disponohet nga shoqëria, pasi këto dokumenta janë dërguar zyrtarisht nga ana e administratës tatimore në adresën e deklaruar të tatimpaguesit si dhe janë të aksesueshme në ndërfaqen e tatimeve eFiling, aksesin e të cilës e kanë personat e autorizuar nga tatimpaguesi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vasilika Vjero

